

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NoHa21” SH.P.K.
DATË 15.03.2021**

Sot, në datën 15.03.2021, **Z. Bledi Balla**, shtetas shqiptar, lindur më 21.09.1987, në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032796124 dhe nr. personal J70921049R, në cilësinë e Ortakut të vetëm Themelues, vendosi të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me emrin **“NoHa21” Shpk**. Kjo shoqëri do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin, i cili i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi, si **Shtoja 1**.

NENI 1 – EMRI

1.1 Shoqëria emërtohet “NoHa21” Shpk.

NENI 2 – FORMA

- 2.1 Shoqëria “NoHa21” Shpk themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (“shpk”) dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 3 – SELIA

- 3.1 Selia e Shoqërisë është vendosur në adresën Rruga “Pjetër Bogdani”, Njësia Bashkiake Nr.5, Ndërtesa Nr. 10, Hyrja 5, Kat 7, Apartamenti 28, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci në adresat e tjera si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit tregtar në fuqi.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendlodë të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, ndërsa Administratori i Shoqërisë ka të drejtë të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresat sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 4 – OBJEKTI

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë konsiston në ushtrimin e aktivitetave të përcaktuara si më poshtë:

- Në fushën e teknologjisë së informacionit: Krijimin, zhvillimin dhe implementimin e programeve kompjuterike, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave kompjuterike, përfshirë edhe tregëtimin me shumicë dhe pakicë të programeve dhe pajisjeve elektronike dhe kompjuterike.*
- Në fushën e këshillimit dhe ofrimit të shërbimeve të formimit profesional: Këshillimin në lidhje me cështje të elektronikës, programimit, projektimit, ndërtimit të rrjetave, cështjeve financiare, ligjore, marketingut/ PR dhe të drejtave të autorit të lidhura me to; Ofrimin e kurseve për formimin profesional dhe formimin vazhdues/trajnime në fushat e mësipërme.*
- Në fushën e ndërmjetësimit dhe shit-blerjes së pasurive të palujtshme dhe tituve: ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit në fushën e shit-blerjes së pasurive të palujtshme dhe transaksioneve të tjera të lidhura me to (qiramarrje, ndërmjetësim për shërbime rinovimi, shfrytëzim si struktura akomoduese dhe përfshirjen në fushën e turizmit, këshillim për përfitimin e skemave të financimit), përfshirë edhe diligencën e të drejtave reale/ tituve të*



pronësisë, të titujve, kuotave, aksioneve, pjesmarrjeve të tjera ne kapitalet e shoqërive ose entiteteve të ndryshme private/ publike. Shfrytëzimin ekonomik i të drejtave të përfituar nga porositja apo blerja e dizenjove, markave, licencave, produkeve të ndryshme të pronësisë intelektuale, pamjeve grafike, filmime si dhe krijime artistike, kinematografike, muzikore etj;

- D. Në fushën e marketingut, kurimit të imazhit, organizimit të eveneve: Realizimin e shërbimeve në fushën e studimit të tregut, krijimin dhe zbatimin e planeve të marketingut dhe buxheteve të tyre, biznes planeve, krijimin e markave dhe kurimin e tyre, ofrimin e shërbimeve të marketingut dixhital, telemarketingut dhe formave të tjera të promovimit, planifikimin dhe organizimin e eveneve, fushatave, konferencave etj.
- E. Të tjera: shoqëria mund të kryejë transaksione tregtare dhe të bashkëpunojë apo të lidhë marrëveshje me kompani vendase dhe të huaja. Të përfshihet në skema financimi, me qëllim realizimin e investimeve dhe të vendosin kufizime, barrë hipotekore apo forma të tjera garantimi të kredive apo mjeteve të tjera të financimit pa kufizim mbi kuotat e shoqërisë dhe/ose asetet e saj, të drejta të tjera të tashme dhe të ardhme.

NENI 5 – KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria themelohet me një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 5.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 6 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë) dhe përbëhet nga një kuotë e vetme e zotëruar nga ortaku themelues z. Bledi Balla, në masën 100% të kontributit në kapital.
- 6.2 Kuotat e Ortakëve të Shoqërisë janë lirisht të transferueshme sipas legjisacionit tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë, por për transferimin e tyre duhet respektuar procedurën e përcaktuar në nenin Statutin e Shoqërisë, Shtojca I.
- 6.3 Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe zotërohet nga Ortaku Themelues z. Bledi Balla, në masën 100%.
- 6.4 Ortakët e Shoqërisë përgjigjet për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të saj.

NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1 Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 – ADMINISTRATORI/ËT

- 8.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpëra mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjeter.
- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushton të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në aktin e emërimit të tij dhe/ose në Statutin e Shoqërisë.
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme ("ad negotia") për kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.

8.4 Caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

"**Z. Bledi Balla**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 21.09.1987, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.032796124 dhe nr. Personal J70921049R."

Specimeni i Firmës së Administratorit të Parë të Shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër	Nënshkrimi
Bledi Balla	

NENI 9 – GJUHA

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.


NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt - Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

“NoHa 21” sh.p.k.

ORTAKU THEMELUES:

Z. Bledi Balla



SHTOJCA I

STATUTI I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“NoHa 21” SH.P.K.

Datë 15.03.2021

KAPITULLI I

EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1 – EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Shoqëria emërtohet "NoHa 21" Shpk.
- 1.2 Shoqëria "NoHa" Shpk themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet me anë të këtij Statuti, Aktit të Themelimit dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

NENI 2 – SELIA

- 2.1 Selia e Shoqërisë është e vendosur në adresën Rruga "Pjetër Bogdani", Njësia Bashkiake Nr.5, Ndërtesa Nr. 10, Hyrja 5, Kati 7, Apartamenti 28, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të çelë, transferojë dhe/ose mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe/ose njësi vendore të çdo lloji, ndërsa, Administratori i Shoqërisë ka të drejtë të çelë dhe/ose transferojë dhe/ose mbyllë adresë sekondare të ushtrimit të veprimtarisë, filiale dhe/ose agjenci.

NENI 3 – OBJEKTI

- 3.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara më poshtë:
 - A. Në fushën e teknologjisë së informacionit: Krijimin, zhvillimin dhe implementimin e programeve kompjuterike, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetave kompjuterike, përfshirë edhe tregëtimin me shumicë dhe pakicë të programeve dhe pajisjeve elektronike dhe kompjuterike.
 - B. Në fushën e këshillimit dhe ofrimit të shërbimeve të formimit profesional: Këshillimin në lidhje me cështje të elektronikës, programimit, projektimit, ndërtimit të rrjetave, cështjeve financiare, ligjore, marketingut/ PR dhe të drejtave të autorit të lidhura me to; Ofrimin e kurseve për formimin profesional dhe formimin vazhdues/ trajnime në fushat e mësipërme.
 - C. Në fushën e ndërmjetësimit dhe shit-blerjes së pasurive të paluajtshme dhe tituve: ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit në fushën e shit-blerjes së pasurive të paluajtshme dhe transaksioneve të tjera të lidhura me to (qiramarrje, ndërmjetësim për shërbime rinnovimi, shfrytëzim si struktura akomoduese dhe përfshirjen në fushën e turizmit, këshillim për përfitimin e skemave të financimit), përfshirë edhe diligencën e të drejtave reale/ tituve të pronësisë, të tituve, kuotave, aksioneve, pjesmarrjeve të tjera ne kapitalet e shoqërive ose entiteteve të ndryshme private/ publike. Shfrytëzimin ekonomik i të drejtave të përfituar nga porositja apo blerja e dizenjove, markave, licencave, produkeve të ndryshme të pronësisë intelektuale, pamjeve grafike, filmime si dhe krijime artistike, kinematografike, muzikore etj;
 - D. Në fushën e marketingut, kurimit të imazhit, organizimit të eveneteve: Realizimin e shërbimeve në fushën e studimit të tregut, krijimin dhe zbatimin e planeve të marketingut dhe buxheteve të tyre, biznes planeve, krijimin e markave dhe kurimin e tyre, ofrimin e shërbimeve të marketingut dixhital, telemarketingut dhe formave të tjera të promovimit, planifikimin dhe organizimin e eveneteve, fushatave, konferencave etj.

E. Të tjera: shoqëria mund të kryejë transaksione tregtare dhe të bashkëpunojë apo të lidhë marrëveshje me kompani vendase dhe të huaja. Të përfshihet në skema financimi, me qëllim realizimin e investimeve dhe të vendosin kufizime, barrë hipotekore apo forma të tjera garantimi të kredive apo mjeteve të tjera të financimit pa kufizim mbi kuotat e shoqërisë dhe/ose asetet e saj, të drejtë të tjera të tashme dhe të ardhme.

NENI 4 – KOHËZGJATJA

- 4.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI II KAPITALI, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

NENI 5 – KAPITALI I SHOQËRISË, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

- 5.1. Kapitali i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë) dhe përbëhet nga një kuotë e vetme e zotëruar nga ortaku themelues z. Bledi Balla, në masën 100% të kontributit në kapital.
- 5.2. Kapitali është nënshkruar dhe do të shlyhet nga ortaku themelues si më poshtë:
 - **Z. Bledi Balla, shtetas shqiptar, i datëlindjes 21.09.1987, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.032796124 dhe nr. Personal J70921049R, 100 lekë.**
- 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, Ortakët Themelues, zotërojnë kapitalin e Shoqërisë si më poshtë:

Ortaku	Kuota	% në Kapital	Vlera
Bledi Balla	1 (një)	100	100 lekë

NENI 6 – ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

- 6.1 Rritja e kapitalit mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, pa kufizim, përmes kontributit në para, në natyrë apo me kredi, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë.
- 6.2 Rritja e kapitalit konsiderohet e kryer në momentin kur kuotat e emetuara dhe të nënshkruara më parë janë shlyer tërësisht.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Statutit të Shoqërisë. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj.
- 6.4 Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

- 7.1 E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, por transferimi i kutave të shoqërisë "NoHa 2021" shpk, pavarësisht formës së tjetërsimit, qoftë përmes dhurimit ose shitjes mund të realizohet vetëm me miratimin e Asamblesë së Ortakëve, e cila duhet të vendosë me shumicë të thjeshtë.
- 7.2 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përvçe kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.



KAPITULLI III ASAMBLEJA E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËT

NENI 8 – ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, TË DREJTAT E PJESËMARRJES DHE VOTËS, THIRRJA

- 8.1 Organ i vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, në të cilën marrin pjesë të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 8.2 Secili ortak ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të votojë, në përputhje me përqindjen e zotëruar prej tij në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.3 Secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga një person tjetër, ortak dhe jo ortak, i pajisur me një prokurë të posaçme, përmes së cilës do të mund të shprehë votën e vet. Në çdo rast, prokura do të mund të lëshohet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Ortakëve dhe është e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.
- 8.4 Ortaku nuk mund të japë prokurë vote për një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij, nëse voton personalisht për një pjesë të saj.
- 8.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë në Shqipëri apo jashtë saj. Pranohet mundësia që mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të zhvillohet me video/telekonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen, t'u mundësohet të ndjekin bisedën, të ndërhyjnë e japin mendimet e tyre në kohë reale lidhur me trajtimin e argumenteve dhe të votojnë në të njëjtën kohë mbi pikat e rendit të ditës. Pas verifikimit të elementeve të mësipërme, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, mbledhja do të quhet e zhvilluar në vendin ku Kryetari i mbledhjes dhe Sekretari, njëkohësisht kanë qenë të pranishëm.
- 8.6 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret prej Administratorit/ve, në rastin kur është e nevojshme për interesat e Shoqërisë apo kur kërcohët nga ligji, sikurse edhe nga një apo më shumë ortakë të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë përmes një kërkësë të shkuar drejtuar Administratorit/ve. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet të paktën një herë në vit brenda muajit të gjashtë të vitit finanziar, me qëllim që të diskutojë, analizojë dhe miratojë bilancin vjetor, raportin e administratorit dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 8.7 Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret përmes një letre rekomande me kthim përgjigje apo me postë elektronike dërguar në adresën e tyre të banimit apo në adresën e tyre elektronike, të paktën 7 (shtatë) ditë përpëra ditës së përcaktuar për zhvillimin e Asamblesë.
- 8.8 Njoftimi duhet të përbajë rendin e ditës dhe të tregojë datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë dhe eventualisht edhe datën, vendin dhe orën e mbledhjes së dytë, nëse e para nuk arrin të mblidhet.
- 8.9 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e thirrur në mënyrë të vlefshme dhe e mbledhur edhe nëse të gjitha formalitetet që kanë të bëjnë me thirrjen e saj nuk janë respektuar, me kusht që i gjithë kapitali i Shoqërisë të jetë i pranishëm apo i përfaqësuar me prokurë dhe që të gjithë ortakët të pranojnë të marrin vendim pavarësisht parregullsisë së thirrjes.
- 8.10 Nëse përmbushen këto kushte, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet si e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari i mbledhjes dhe ku gjithashtu duhet të ndodhet edhe Sekretari, në mënyrë që të aprovojnë zbardhjen dhe nënshkrimin e procesverbalit mbi librin përkatës.
- 8.11 Në thirrjen e mbledhjes së Asamblesë e Përgjithshme duhet të janë të përcaktuar vendet, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, apo me video/telekonferencë nën kujdesin administratorit të Shoqërisë, ku Ortakët do të mund të mblidhen.

- 8.12 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga një Kryetar i emëruar nga Ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në Asamble. Nëse prania e një noteri nuk është e kërkuar nga kuadri ligjore në fuqi, Asambleja zgjedh një Sekretar, i cili mund edhe të mos jetë Ortak.
- 8.13 Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme ka të drejtë të plotë të verifikojë prokurat dhe vlefshmérinë e tyre, të drejtën e Ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamble, dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nëse kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime është arritur vlefshmérish. Kryetari ka edhe të drejtën të kryesojë bisedimet dhe të marrë vendime mbi rregullat dhe procedurat lidhur me votën.
- 8.14 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve të Asamblesë duhet të përgatiten menjëherë pas Asamblesë dhe duhet të nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë, sikurse edhe prej noterit, kur kjo kërkohet nga kuadri ligjor në fuqi. Lista e pjesëmarrësve i bashkëlidhet procesverbalit të mbledhjes si dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me vendimmarjen e Asamblesë së Përgjithshme. Administratori/ët, është/janë përgjegjës për mbajtjen e kopjes së dokumentacionit të sipërcituar.

NENI 9 –KOMPETENCAT E ASAMBLESË DHE KUORUMI

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
 - transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjetër;
 - pjestimin e kuotave të Shoqërisë dhe anulimin e tyre;
 - përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planit strategjik të zhvillimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
 - miratimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshimi të tyre;
 - miratimin e pasqyrave financiare në mbyllje të çdo viti ushtrimor dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
 - miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
 - emërimin dhe shkarkimin e Administratorit, si dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
 - miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
 - miratimin e krijimit të shoqërive të bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe bashkëpunimeve të cilët do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja;
 - blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënen e kontributit në kapitalin e shoqërite të tjera;
 - miratimin e kërkesave të reja dhe rinvimin e kërkesave ekzistuese për financimin Shoqërisë apo subjekteve/palëve të treta;
 - vendosjen e barrëve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloji tjetër mbi pasuritë e Shoqërisë;
 - dhënen e çdo garancie korporative ose nënshkrimin e çdo marrëveshje të tjetër për të siguruar përbushjen e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve;
 - shitjen e shoqërisë ose degëve të saj;
 - shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë.
- 9.2 Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.



- 9.3 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesën e njërit prej Ortakëve, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërisht brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëtin rend dite.

NENI 10 – ADMINISTRATORI/ËT

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratori/ët do të qëndrojë/në në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjeter.
- 10.2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë dhe ushtron/jnë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e administratorimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme/ aktet e emërimit të tyre. Përveç kompetencave të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare përmes këtij Statuti, Administratori ka të drejtë të hartoje, formalizojë dhe komunikojë procedurat e brendshme, urdhrat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose si detyrim i legjislacionit në fuqi për fusha të caktuara nga të cilat ndikohet veprimtaria e Shoqërisë, ose që prodhojnë detyrime/ të drejta për të.
- 10.3 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë të posaçme ("ad negotia") kryerjen e një veprimi ose disa veprimeve, në kufijtë e tagrave që i/u janë dhënë nga ligji, statuti dhe/ose akti i emërimit.
- 10.4 Caktohet si Administrator i parë i Shoqërisë:
"Z. Bledi Balla, shtetas shqiptar, i datëlindjes 21.09.1987, lindur dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr.032796124 dhe nr. Personal J70921049R"

NENI 11 – EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

- 11.1 Nëse kërkohet nga ligji ose një vendim i tillë merret nga Asambleja e Përgjithshme, pasqyrat financiare dhe librat kontabel të Shoqërisë do të kontrollohen/ auditohen nga një apo më shumë ekspertëve kontabel të autorizuar.
- 11.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund të revokohet në çdo çast në bazë të kushteve të përcaktuara nga legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI USHTRIMOR, PASQYRAT FINANCIARE VJETORE DHE SHPËRNDARJA E FITIMEVE

NENI 12 – VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR

- 12.1 Viti ushtrimor fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.
- 12.2 Viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe përfundon më 31 Dhjetor, të të njëjtit vit.
- 12.3 Pasqyrat financiare dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratori dhe raporti që hartohet nga eksperti kontabel i emëruar (në rast se është emëruar një i tillë), miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 12.4 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i këtij vitit.



NENI 13 – FITIMET

- 13.1 Fitimet neto që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, i shpërndahen Ortakëve në përpjesëtim me pjesët takuese të tyre në kapitalin e Shoqërisë.
- 13.2 Asambleja, gjithashtu, mund të vendosë të mbajë shuma të caktuara si rezerva, apo të shtyjë shpërndarjen e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht për vitin/et ushtrimore pasardhës.

**KAPITULLI V
SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË****NENI 14 – SHPËRNDARJA**

- 14.1 Shoqëria shpërndahet në përfundim të afatit të saj parashikuar në Statut apo edhe përpara këtij afati, në rastet e parashikuar nga ligji apo me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e parashikuar për ndryshimin e Statutit të Shoqërisë.
- 14.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast paaftësie, vdekje apo falimentimi të ortakëve.

NENI 15 – LIKUIDIMI

- 15.1 Në rast shpërndarjeje Shoqëria do të kalojë në proceduren e likuidimit.
- 15.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar mbi gjendjen e pasivit dhe aktivit të Shoqërisë, mbi veprimet e likuidimit dhe kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 15.3 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendim në lidhje me bilancin financier përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuidatorit dhe mbi përfundimin e procedurës së likuidimit.
- 15.4 Pas kryerjes së pagesës së kreditorëve/ëve dhe tërheqjes së kredive, likuidatori/ët do të shpërndajnë të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, proporcionalisht me kuotat që ata respektivisht kanë në kapitalin e Shoqërisë.

**KAPITULLI VI
DISPOZITA TË FUNDIT****NENI 16 – ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 16.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtyre dispozitave të këtij Statuti, midis ortakëve ose midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen me marrëveshje mes palëve. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje me marrëveshje, palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 17 – DISPOZITAT LIGJORE NË FUQI

- 17.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.
- 17.2 Autorizohet administratori i shoqërisë që të regjistrojë Shoqërinë në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Miratuar nga:

Ortaku Themelues:

Z. Bledi Balla

Bledi Balla
